

K O S O V O



**KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE**

Prishtinë, 26.04.2023

Komiteti Olimpik i Kosovës ka statusin e personit juridik. Është e regjistruar si organizatë joqeveritare në Kosovë dhe misioni i saj është promovimi i Lëvizjes Olimpik brenda Republikës së Kosovës. Komiteti Olimpik i Kosovës është i përkushtuar të respektojë dispozitat e Kartës Olimpik, si i tillë, Komiteti Olimpik i Kosovës bashkëpunon me të gjitha organizatat sportive të Republika e Kosovës, hyn në bashkëpunime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, punëson dhe angazhon persona juridikë dhe individë të tjerë të cilët janë të nevojshëm për arritjen e misionit dhe qëllimeve të saj.

Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës me qëllim të arritjes së qëllimeve dhe misionit të tij afatgjatë, kanë parë të nevojshme për të bërë këtë thirrje publike për aplikim për: “Ekspert të lartë Ligjor/Koordinator” për nevojat e Komitetit Olimpik të Kosovës, andaj kërkojmë oferta nga individët si më poshtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR EKSPERT TË LARTË LIGJOR / KOORDINATOR

Mbështetje Komitetit Olimpik të Kosovës dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në hartimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Sport si dhe mbështetje në hartimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e dukurive negative në evente sportive.

1. Sfondi

MKRS së bashku me Komitetin Olimpik të Kosovës janë në procesin e krijimit të politikave dhe rishikimit të legjislacionit me qëllim përmirësimin e sektorit dhe krijimin e një ambienti sa më të favorshëm për zhvillimin e sportit në vend.

Aktualisht, MKRS dhe KOK janë në fazën e finalizimit të Strategjisë së Sportit e cila strategji parashah objektiva dhe targete të caktuara për zhvillimin e sektorit dhe adresimin e problemeve të identifikuar me palët e interesit të përfshira në proces si dhe gjithashtu adreson disa nga çështjet që janë trajtuar në kuadër të Koncept Dokumentit për Sport.

2. Përshkrimi i detyrës

Eksperti/koordinatori vendor i kontraktuar, do të mbështesë Komitetin Olimpik të Kosovës si dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në hartimin e dy ligjeve atij të sportit dhe atij për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive. Gjithashtu në këtë drejtim, do të ofroj mbështetje në propozimet e akteve nënligjore të cilat do të derivojnë nga këto dy ligje.

3. Detyrat kryesore

Eksperti/koordinatori do të:

- a) Koordinoj punën në mes të ekspertëve të angazhuar, si dhe koordinoj punën me KOK dhe MKRS;

- b) Ofrojë mbështetje në hartimin e dispozitat përkatëse të Ligjit për Sport si dhe dispozitat përkatëse të Ligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive si dhe paraqes propozimet për aktet nënligjore përkatëse;
- c) Konsultoj palët e përfshira në proces gjatë hartimit të ligjit;
- d) Sipas nevojës të mbështesë autoritetet me dokumente dhe informata shtesë për hartimin e memorandumit shpjegues.

4. Kohëzgjatja e kontratës dhe angazhimit

Kohëzgjatja e angazhimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës dhe do të përfundoj më së largu deri më 31 dhjetor 2023.

Për realizimin e aktiviteteve në kohë, eksperti/koordinatori në bashkëpunim me ministrinë, do të hartoj planin dinamik të punës për të siguruar përmbushjen e detyrave të përcaktuara në Termat e Referencës.

Plani i punës duhet të koordinohet ngushtë me Komitetin dhe Ministrinë si dhe t'i përshtatet kërkesave.

5. Kriteret e pagesës dhe oferta

Eksperti/Koordinatori do të ofroj shërbrimet e tij/saj për ditët e angazhuara dhe parashihet që maksimumi i ditëve punuese të jetë 80 ditë. Çdo kosto e buxhetit do të përfshihet në shumën e pagesës për ditë.

6. Kualifikimet

Eksperti duhet të plotësojë kriteret e më poshtme:

- Diplomë Unversitare në njërin nga këto drejtime: Juridik, Integrim Evropian, Politika Publike apo Qeverisje Lokale. Është e preferuar që kandidatët të kenë edhe master në njërën nga fushat e lartcekura ose në fushën e ndërlidhur me sektorin e sportit;
- 6 vite përvojë në hartimin e legjislacionit primar apo sekondar;
- Përvojë me institucionet publike të nivelit qendror dhe atij lokal në hartimin e legjislacionit;
- Njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës Angleze. Njohja e gjuhëve tjera është përparësi.
- Shkathtësi të forta të organizimit, shkathtësi ndërpersonale dhe atë të komunikimit.

7. Menyra e Aplikimit

Kandidati duhet të dorëzoj:

- CV-në;
- Ofertën financiare për angazhimin.

Dokumentet duhet të dërgohen përmes emailit në legal@noc-kosovo.org dhe afati për të aplikuar përfundon me datë 05.05.2023 në ora 23:59. Vetëm kandidatët më të suksesshëm do të kontaktohen për intervistim.